

## AKT THEMELIMI

---

### Shoqeria “Gjerazi Coaching & Trainings” sh.p.k

Sot më datë 03/08/2023, une e nënshkruara **zj. Elonora Gjerazi** shtetase shqiptare, e datelindjes 23/01/1953, banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit nr F35123031E shpreh vullnetin tim për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “Gjerazi Coaching & Trainings” sh.p.k si më poshtë vijon:

#### 1. FORMA LIGJORE

“Gjerazi Coaching & Trainings” sh.p.k është një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar.

#### 2. ORTAKET THEMELUES

Ortaku themelues i shoqërisë është Elonora Gjerazi.

#### 3. OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “Gjerazi Coaching & Trainings” sh.p.k. është “Seanca trajnimi për individ dhe grupe, si dhe trajnime për leadership e zhvillim profesional e personal.”

#### 4. SELIA

Selia e shoqërisë tregtare “Gjerazi Coaching & Trainings” sh.p.k është në adresën: Rruga Ferit Xhajko, Pall.65/3, Shkalla 2 , Ap.19, Tirane.

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [hello@migenagjerazi.com](mailto:hello@migenagjerazi.com)  
Shoqëria ka të drejtë të hapë degë dhe të zhvillojë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### 5. KOHËZGJATJA

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të pacaktuar, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në paragrafin 1, të këtij neni mund të shkurtohet me vendim të Asamblese së Ortakeve të shoqërisë, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Statuti i shoqërisë.

#### 6. KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “Gjerazi Coaching & Trainings” sh.p.k. është 100.000 (Njëqind mije) leke i perfaqësuar nga 1 kuote , vlera nominale e të ciles është 100.000 (Njëqinde mije) leke.

Ortakët janë zotues të kuotës që përfaqësojnë 100 % të kapitalit të shoqërisë .  
Kuotat janë nominative dhe nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë.  
Kuotat përfaqëson të drejtën e një votë.

## 7. ORTAKËT

Ortakët i ushtrojnë kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Ortakëve.

## 8. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

- Shoqëria drejtohet nga 1 (një) Administrator.
- Administratori i shoqërisë “**Gjerazi Coaching & Trainings**” sh.p.k do të jetë **Zj. Migena Gjerazi**, mbajtese e leternjoftimit nr I05719124C. Administratori emërohet me Vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 (pese) vjet me të drejte ripërtëritjeje.
- Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**Gjerazi Coaching & Trainings**” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe statuti, i përket administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkoje për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

## 9. SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkakut ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

**THEMELUESI**

**Elonora Gjerazi**

*Elonora Gjerazi*  
*[Signature]*